17 e të tjerët. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Si rezultat i pozicionit të tyre si anëtarë themelues ose
20 si ushtarë të parë të UÇK-së, këta anëtarë që në ditët e para
21 të vitit 1998 kanë marrë role komanduese në zonë. A është e
22 saktë kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Agron Xhemajli për pasojë, së bashku me këta personat e
25 tjerë, ka qenë komandant që nga fillimi i verës së vitit 1998.

1 Kështu?

2 PË. E ka pas një, një rol kyç, të caktum në brigadë.

3 PY. Kur jeni kyçur në fillim në UÇK, në fillim të verës së
4 vitit 1998, ai ka qenë eprori yt, apo jo?

5 PË. Ka qenë eprori i të gjithëve. Një pjese.

6 PY. Po. Megjithatë, të jemi të qartë sa i takon kohës.

7 Domethënë, kur jeni kyçur në UÇK nga muajt e parë të vitit

8 1998, i takon që ai ka qenë komandanti ose eprori yt që në

9 fillim fare, që prej fillimit. A ka qenë kështu, Dëshmitar?

10 PË. Po, ka qenë epror, po na nuk e kemi ditë -- ehh -- ato të

11 tynet, cili ka qenë komandant, cili ka qenë -- të gjithë në --

12 në organizim të -- të UÇK-së në zonën në Gollak. Si Fatmir

13 Sopi, si Agron Xhemajli, si Salih Mustafa, si Sejdi Veseli. Të

14 gjithë kanë qenë në organizim të Ushtrisë Çlirimtare të

15 Kosovës.

16 PY. Ndërkohë që mbase nuk e keni ditur titullin e tij ekzakt

17 në atë kohë, besoj që e keni kuptuar që ai ka qenë më i lartë

18 në ty në -- se ti në rang dhe se ushtarët e tjerë. Domethënë

19 ka qenë eprori juaj. Besoj këtë e keni kuptuar, apo jo?

20 PË. Po, po.

21 PY. Dhe sikurse na e thatë, pra, epror të tjerë kanë qenë

22 edhe persona të tjerë që sapo përmendët, përveç Agron

23 Xhemajlit. Kështu?

24 PË. Po, kanë qenë --

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është

1 keqinterpretim i dëshmisë. Ai thjesht sa i përmendi këta emra
2 si organizatorët e UÇK-së, por nuk është se tha se çfarë
3 rolesh kanë pasur këta persona.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

5 ZNJ. ROWAN [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, a na sqaroni pak ju lutem në qoftë se personat
7 që ju sapo përmendët kanë qenë anëtarë themelues të UÇK-së dhe
8 kanë qenë gjithashtu eprorë, kanë qenë më të lartë në hierarki
9 sesa ju në muajt e verës të vitit 1998?

10 PË. Po, e vërtetë është.

11 PY. Faleminderit që na e sqaruat këtë. Përpara një çasti, kur
12 po përmendnit Agron Xhemajlin, thatë "të gjithë -- i të
13 gjithëve ne". A mund ta sqaroni që ai nuk është se ka qenë
14 vetëm thjesht eprori juaj, por ka qenë gjithashtu edhe eprori
15 i të gjithë atyre, të cilët kanë qenë pjesë e policisë
16 ushtarake. Jo vetëm i yti, por edhe i të tjerëve.

17 PË. Po ka qenë eprori i të gjithëve. Ashtu e dimë ne.

18 PY. Kështu e keni kuptuar ju. Kështu e dini ju, kështu?

19 PË. Po. Shukri Rafuna u bë komandanti i policisë ushtarake i
20 Brigadës 153 në fillim të vitit 1999. A është e saktë kjo?

21 PY. Po.

22 PË. Megjithatë, deri në momentin që mbërriti Rafuna, ju
23 urdhrat i keni marrë nga Xhemajli dhe komandantët e tjerë që
24 diskutuam, apo jo?

25 PY. Po. Nga Agron Xhemalji më së shumti.

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 54

1 PË. Po. Pra, që prej fillimit deri sa mbërriti Rafuna, Agron
2 Xhemajli, gjatë gjithë kësaj periudhe, deri në momentin të
3 mbërritjes së Rafunës, ka qenë personi që jepte urdhrat,
4 kështu?

5 PY. Po, sa i përket neve, po.

6 PË. I keni thënë ZPS-së më herët, dhe do citoj këtu çfarë
7 keni thënë:

8 "Deri në momentin kur erdhi Shukri Rafuna, deri në atë
9 moment, ne i njoftonim ose i raportonim Agron Xhemajlit."

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem na jepni referencën.

11 ZNJ. ROWAN [Përkthim] Po, patjetër. Referenca është
12 intervista e ZPS-së, Pjesa 1, 072914-TR-ET, rreshti 10, faqja
13 18.

14 PY. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar. Atëherë, pyetja është kjo:
15 Pas mbërritjes së Rafunës, a vazhduat që të merrnit urdhra nga
16 Agron Xhemajli? Apo pas mbërritjes së tij, domethënë të
17 Rafunës, vazhduat që të merrnit urdhra vetëm prej këtij të
18 fundit, jo prej Xhemajlit?

19 PË. Po, vetëm prej këtij të fundit.

20 PY. Dëshmitar, kur thoni "vetëm prej këtij të fundit" a na e
21 sqaroni pak për kë e keni fjalën?

22 PË. Për Shukri Rafunën.

23 PY. A e kuptoj drejtë që po thoni që pasi mbërriti Shukri
24 Rafuna ju i keni raportuar këtij dhe keni marrë urdhra prej
25 tij, kështu?

1 PË. Po, ashtu është.

2 PY. Faleminderit. Na keni sqaruar se Agron Xhemajli kishte
3 kompetenca që të jepte urdhra si për policinë ushtarake dhe
4 për brigadën. A mund të na e sqaroni po ashtu sa i takon
5 njësive që funksiononin në Gollak në atë kohë. A është e
6 vërtetë ose është e saktë që njësitë i raportonin edhe Agron
7 Xhemajlit, por edhe komandantit të brigadës? Po flasim për
8 raportimin këtu vetëm.

9 PË. Kanë -- i janë raportuar edhe Agronit, po i kanë raportu
10 komandantit.

11 PY. Sa për sqarim, këta do ishin Fatmir Sopi, në fillim, dhe
12 pastaj Adem Shehu, nga viti 1999, nga fillimi i vitit 1999.
13 Kështu është?

14 PË. Po.

15 PY. Kur keni folur me ZPS-në, keni shpjeguar më herët për
16 ZPS-në se nuk ka pasur ndonjë tipar dallues midis ushtrisë dhe
17 policisë ushtarake. Dëshiroj që t'iu lexoj mënyrën se si e
18 keni shpjeguar pozicion -- këtë gjë për ZPS-në.

19 ZNJ. ROWAN [Përkthim] Për procesverbal, referenca është
20 P01645.1, rreshti 10, faqja 18.

21 PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

22 "Agron Xhemajli a i jepte detyra policisë ushtarake, apo
23 brigadës?"

24 Përgjigja që ju jepni është kjo:

25 "Jepte detyra si policisë ushtarake dhe brigadës se ne

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 56

1 ishëm të njëjtët. Nuk kishte dallim midis policisë ushtarake
2 dhe nesh. Ne ishëm të barabartë. Policia ushtarake dhe ushtria
3 ishin e njëjta gjë. Ne ishëm të njëjtët dhe detyrë shtesë që
4 kishim ishte që ne të kujdeseshim për ushtarët dhe të
5 siguronim që nuk kishte sjellje të pakëndshme ose veprim,
6 veprimtari të pakëndshme.”

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem flisni pak më
8 ngadalë për përkthyesit.

9 ZNJ. ROWAN [Përkthim] Do e përsëris edhe një herë për t'u
10 kapur nga përkthyesit.

11 PY. Ju thoni këtë, z. Berisha:

12 “Ne ishëm të barabartë. Detyrat shtesë që kishim ishin që
13 duhet të kujdeseshim për ushtarët dhe të siguroheshim që nuk
14 kishte sjellje të pakëndshme, ose akte që do të ishin të
15 pakëndshme në -- sa i takon sjelljes të tyre.”

16 PË. Po, e vërtetë është.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Dëshmitar, do bëjmë
19 pushim prej gjysmë ore tani. Do të vijmë përsëri në Gjykatë në
20 orën 11.30. nuk duhet të flisni me askënd jashtë sallës së
21 gjyqit dhe në qoftë se dikush përpigjet që të flasë me juve,
22 këtë duhet të na e bëni me dije ne.

23 Znj. Sekretare e seancës mund ta nxirrni dëshmitarin nga
24 salla tani.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes

1 videolidhjes]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Tully?

3 Z. TULLY: [Përkthim] Kam një diçka për logjistikë. Ekipi
4 i Selimit do bëjë pyetjet për dëshmitarin pas kësaj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan, a
6 mund të na thoni sa kohë ju duhet?

7 ZNJ. ROWAN [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që ne
8 kemi kërkuar një orë. Kemi përdorur vetëm 10 minuta. Nuk
9 pretendoj që të shpenzojmë të gjithë orën e planifikuar,
10 megjithatë do të na duhen rreth 15 deri në 20 minuta më pas.
11 Besoj deri nga ora 12.00.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund t'ju them edhe unë për
13 arsye planifikimi që ne do të na duhen 1- deri në 20 minuta
14 për të marrë në pyetje, dhe jo 30 minuta.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
16 për përditësimin. Do të bëjmë pushim tani, deri në orën 11.30.

17 --- Pauza fillon në orën 11.04

18 --- Seanca rifillon në orën 11.33

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 sillni dëshmitarin në ambientin ku ndodheni.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
23 vazhdoj me pyetjet e veta avokatja e z. Veseli.

24 Znj. Rowan, fjala është për ju.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

1 PY. Mirë se u kthyet, z. Berisha. Përpara pushimit --

2 PË. Faleminderit.

3 PY. -- pra, përpara pushimit, unë po ju lexoja dëshminë edhe
4 intervistën që i keni dhënë ZPS-së dhe ku thatë se ushtria dhe
5 policia ushtarake ishin të njëjta dhe ju konfirmuat që kështu
6 ishte.

7 Tani unë dua një sqarim, sipas jush i vetmi dallim mes
8 ushtrisë dhe policisë ushtarake ishte vetëm fakti që policia
9 ushtarake kishte një detyrë ekstra që ishte të kujdesej që
10 ushtarët të mos silleshin keq, pra, kjo ishte detyra e vetme
11 shtesë që kishte policia ushtarake sipas jush.

12 PË. Po.

13 PY. Tani, sa i takon lidhjes, marrëdhënies mes policisë
14 ushtarake dhe brigadës suaj dhe shërbimit informativ të
15 brigadës suaj, a është e vërtetë që këto ishin dy funksione të
16 ndara brenda brigadës dhe se shërbimi i informimit nuk ishte
17 pjesë e policisë ushtarake?

18 PË. Po, nuk ishin pjesë e policisë ushtarake.

19 PY. Z. Berisha, unë do ju lexoj përshkrimin që i ka bërë
20 Agron Xhemajli, një përshkrim të Agron Xhemajlit ku flet për
21 marrëdhënien me ju. Do përpiqem të lexoj ngadalë për
22 përkatësit, i bënë një pyetje Agron Xhemajlit:

23 "Çfarë roli ka pasur Halim Berisha në brigadë" --

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Na jepni referencën.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Referenca është 076501-TR-ET,

1 faqja 5, rreshti 1.

2 PY. Pra, z. Berisha dhe një herë, Agron Xhemajlit i kanë bërë
3 këtë pyetje:

4 "Çfarë roli kishte Halim Berisha në brigadë?"

5 Ai është përgjigjur kështu:

6 "Ai ka qenë pjesë, një ushtar i thjeshtë në brigadë dhe
7 pjesë e njësisë së lagjes së tij në Cervanik..."

8 Dhe ai ka thënë:

9 "Ka pasur rol në polici ushtarake."

10 I kanë bërë një pyetje.

11 "Po në prill të 1999?"

12 Ai u përgjigj:

13 "Nuk më kujtohet çfarë ka bërë në prill. Mbase më vonë u
14 bë pjesë e asaj që ne quanim policia ushtarake po nuk më
15 kujtohet ..."

16 "PY. A ka qenë vartës i juaj, pra, ka qenë në varësinë
17 tuaj?"

18 Dhe Agron Xhemajli ka thënë kështu.

19 "Jo, nuk e kam pas vartës të drejtpërdrejtë, por ka qenë
20 ushtar i thjeshtë, si të gjithë ushtarët, unë kam qenë
21 komandant, pra, në një farë mënyre ai ka qenë vartësi im
22 njësoj si ushtarët e tjerë."

23 Z. Berisha, pajtoheni ju me përshkrimin që ka bërë z.
24 Xhemajli?

25 PË. Jo. Se unë prej fillimi kur jam kyç --

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 60

1 PY. Na e sqaroni çfarë nuk përputhet?

2 PË. Nuk përputhen --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

4 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Nuk përputhet deklarata
5 e tina se unë pej fillimit kur jam kyç në Ushtrinë Çlirimtare
6 të Kosovë kam shërbyer në njësinë e ushtrisë së policisë
7 ushtarake. Pej fillimi deri në mbarim kam qenë në atë njësi.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

9 PY. Po. Z. Xhemajli në fakt tha që nuk i kujtohej që kur ke
10 qenë në policinë ushtarake. Po sa i takon varësisë, pra, që a
11 i raportoje ti atij, a pajtohesh me përshkrimin që i ka bërë
12 ai linjës së varësisë?

13 PË. S'po e kuptoj pyetjen. Lidhjen e varësisë?

14 PY. Është faji im z. Berisha. Unë po ju bëj këtë pyetje kaq
15 të thjeshtë. Sepse ju keni sqaruar disa herë sot që
16 marrëdhënia mes jush dhe z. Berisha ishte vetëm fakti që ai
17 ishte eprori juaj. Vetëm kaq s'kishit lidhje tjetër me të,
18 thjesht që ka qenë eprori juaj, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Faleminderit. Tani si eprori juaj, sigurisht, që ai
21 kishte kompetencën që të caktonte detyra, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. A është e vërtetë që kompetenca e tij buronte për vetë
24 faktin që ai ishte eprori i juaj, saktë?

25 PË. Edhe një herë pyetjen?

1 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Mendoj se ka nevojë të
2 korrigjohet diçka në transkript. Mbase kolegja bëri një gabim
3 kur foli tha "marrëdhënia mes jush dhe z. Berisha".

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, ishte gabimi im, duhet të
5 kisha thënë në fakt z. Xhemajli.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 përsëriteni dhe një herë pyetjen.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për cilën pyetje?

9 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Është faqja 53, rreshti 14.
10 PY. Z. Berisha, ju lutem dhe një herë, sa i takon
11 marrëdhënies që kishit ju me z. Xhemajli, a është e vërtetë që
12 z. Xhemajli ka qenë epror i juaj? Ju kërkoj ndjesë, bëra një
13 gabim më herët.

14 PË. Po. Po, po ka qenë.

15 PY. Faleminderit.

16 Tani, sa i takon autoritetit që kishte z. Xhemajli për
17 t'ju dhënë detyra, a është e vërtetë që ai e kishte këtë
18 autoritet, pra, ai mund t'ju jepte ju detyra për vetë faktin
19 se ai ishte epror juaj, a pajtoheni me këtë?

20 PË. Po, normal. Çdo epror kishte të drejtë me dhënë urdhna.

21 PY. Pikërisht. Po a pajtoheni ju që fakti që kishte ai
22 autoritet t'ju jepte ju detyra nuk lidhej fare me rolin që
23 kishte ai më pas në shërbimin informativ?

24 PË. Jo, jo, nuk kishte.

25 PY. Përveç Agron Xhemajlit, a është e vërtetë që brenda

1 brigadës suaj nuk ka pasur ushtarë të tjerë apo eprorë për
2 përgjegjës për shërbimin e informimit?

3 PË. Nuk njohuri. Nuk di.

4 PY. Të flasim pak për rolin e Agron Xhemajlit në shërbimin e
5 informimit. Ju ka bërë më herët Prokuroria pyetje lidhur me
6 këtë. Është e vërtetë, që mesa keni kuptuar ju, roli i z.
7 Xhemajli ka qenë shefi i shërbimit të brigadës dhe sipas jush
8 ai mblidhte informacione zbulimi, kundërzbulimi dhe
9 veçanërisht mblidhte informacion sa i takon armiqve të UÇK-së,
10 elementëve armiqësor të UÇK-së?

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem, na jepni referencën.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] P01645.1, faqja 21, rreshti 3.

13 PY. Kështu, Dëshmitar?

14 PY. Jo, nuk e di unë. Për atë gjë nuk e di. Nuk po s'e di që
15 ka qenë shef i shërbimit informativ, çka ka punue, qysh ka
16 veprue nuk i di.

17 PY. Pra, kur ju i thatë ZPS-së që mënyra sesi e kisha kuptuar
18 unë detyrën e tij ishte që të mblidhte informacione për
19 elementet armiqësorë, ju nuk e kishit të qartë në realitet se
20 çfarë bënte ai, apo jo?

21 PË. Jo.

22 PY. Unë do t'ju lexoj se si e ka përshkruar vetë Agron
23 Xhemajli rolin e tij. Ai në të shkuarën ka thënë kështu:

24 "Si e kam kuptuar unë rolin tim me mjetet e mia, sepse
25 askush s'ma ka shpjeguar mua rolin që kisha. Unë mblidhja

1 informacione në terren për pozicionet serbe, forcat e
2 armatosura, forcat e armatosura serbe, sepse ata po na
3 sulmonin në çdo moment dhe unë doja të zbuloja se ku
4 qëndronin.”

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Referenca për këtë është me numër
6 76501-TR-ET Pjesa 1, faqja 16, rreshti 8.

7 PY. Z. Berisha, a e kontestoni ju përshkrimin që i ka bërë z.
8 Xhemajli rolit të tij?

9 PË. Jo, s'e kontestoj se nuk e di se ai mu s'më ka raportu
10 çfarë detyre kryen. Nuk di.

11 PY. Z. Xhemajli ka thënë në shkuarën që një prej detyrave të
12 tij nuk ishte identifikimi i kolaboracionistëve. E kontestoni
13 ju këtë?

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kundërshtoj, s'ka nga ta dijë
15 Dëshmitari këtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet,
17 kundërshtimi.

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

19 PY. Sa i takon informacioneve për forcat serbe, pozicioneve
20 të forcave serbe, ju personalisht, e keni parë ndonjëherë z.
21 Xhemajli të vijë në brigadë dhe të thotë, t'ju japë ju
22 informacione që kishte mbledhur ai për forcat serbe? Pra, ka
23 ardhur ndonjëherë ai vetë dhe ju ka thënë gjë lidhur me
24 pozicionet e forcave serbe?

25 PË. Jo, ai nuk ka ardh me na thënë neve kurrëgjë për forcat

1 serbe, po faktikisht ai a kanë aty në brigadë, më së shumti ka
2 qenë aq sa di në brigadë.

3 PY. Sa u takon detyrave të tjera të tij - dhe referenca për
4 këtë që po them është 076501-TR-ET, faqja 16, rreshti 19 - ai
5 ka thënë se ka pasur shumë detyra në brigadë një prej detyrave
6 ishte të sigurohej që kishte ushqim, armë, tesha, mjekime,
7 furnizime të tjera.

8 Ju e keni parë ndonjëherë z. Xhemajli t'i kryente këto
9 detyrat që sapo përmendëm?

10 PË. Po, është e vërtetë. Jo, veç ai, po kanë pas të gjithë
11 obligim të kujdesen për ushtarët dhe të sigurojnë ushqim,
12 veshmbathje, armë. Çdonjëni e kemi pas obligim.

13 PY. Tema e fundit që dua të diskutojmë bashkë është çështja e
14 vijës së raportimit, si funksiononte raportimi dhe kush kishte
15 kompetencat për të ndarë detyrat.

16 Pavarësisht faktit që ju ishit një ushtar dhe më pas në
17 polici, të bënë disa pyetje nga ana e Prokurorisë për vijën e
18 raportimit. Ju kujtohet që ua bëri Prokuroria këto pyetje?

19 PË. Po.

20 PY. Tani, z. Berisha, unë dua të shohim bashkë disa nga
21 përgjigjet që keni dhënë ju në të kaluarën dhe të sqarojmë
22 disa prej tyre. Fillimisht unë dua të di, ju personalisht
23 çfarë dini, pra, dua ta ndani çfarë keni menduar dhe çfarë
24 keni ditur drejtpërdrejt dhe çfarë ju kanë thënë personat.
25 T'i ndajmë këto të tria pra.

1 PË. Nuk po e kuptoj çka?

2 PY. Po jo, nuk ishte pyetje. Nuk ka problem. Thjesht po ju
3 jepja kontekstin, po ju shpjegoja pse do t'i bëj pyetjet që do
4 bëjë që ta kuptoni për kontekst.

5 PË. Po.

6 PY. Unë dua të fokusohemi në disa nga përgjigjet që i keni
7 dhënë ju Prokurorisë në të kaluarën kur ju ka bërë pyetje. Për
8 shembull, një nga pyetjet ka qenë nga i merrte urdhrat Agron
9 Xhemajli.

10 PË. Po, më kujtohet ajo. Po.

11 PY. T'ju lexoj përgjigjen.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për këtë referenca -- është provë
13 materiale tani - është me numër P01645.3, faqja 22, rreshti 15
14 në shqip.

15 PY. Z. Berisha, ju ka bërë këtë pyetje Prokuror:

16 "Nga kush i ka marrë urdhrat Agron Xhemajli? Kush ia
17 jepte detyrat?"

18 Ju keni thënë:

19 "Mesa kam unë dijeni, mesa kam kuptuar unë, i ka marrë
20 urdhrat nga shtabi i zonës së Llapit.

21 "PY. Në veçanti prej kujt?"

22 Ju jeni përgjigjur:

23 "Nuk e di. Nuk e di prej kujt saktësisht, por e di që
24 Agron Xhemajli kishte kompetenca të plota si shef i shërbimit
25 të informimit dhe se i raportonte zonës, shtabit. Kështu e kam

1 kuptuar unë.

2 "PY. Në rregull. Po nga e dini ju që i raportonte
3 komandës së zonës?

4 "PË. E dinim edhe nga të tjerët. Si fshihnim gjë njëri-
5 tjetrit."

6 Më poshtë në tekst në faqen 20, rreshti 3, ju kanë bërë
7 këtë pyetje ju, z. Berisha, Prokurori u ka bërë këtë pyetje:

8 "Pra, a po na thoni ju që policia ushtarake në Brigadën
9 153 i merrte detyrat nga Agron Xhemajli dhe se Agron Xhemajli
10 i merrte nga komanda e zonës. Kështu ka funksionuar?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe ju jeni përgjigjur kështu:

13 "Nuk e di. Nuk e di drejtpërdrejti nga i merrte detyrat
14 apo urdhrat, ai merrte nga komanda e zonës apo i merrte nga
15 shefi i shërbimit të informimit ... po unë di një gjë që Agron
16 Xhemajli kishte kompetenca të plota për të arrestuar jo vetëm
17 një ushtar, por ushtarë e komandantë. Unë nuk e di nga i
18 gjente ai këto kompetenca, por kompetencat për ta bërë këtë i
19 kishte të plota."

20 PË. Po.

21 PY. Tani çfarë dua të bëjë unë është ta zbërthejmë pak
22 deklaratën tuaj. A është e vërtetë që ju e dinit se Agron
23 Xhemajli i kishte kompetencat si shef i shërbimit të
24 informimit, kështu?

25 PË. Po, ka pas kompetenca si shef i shërbimit informativ.

1 PY. Dhe ju e këtë e dini se e keni parë vetë me sytë tuaj në
2 brigadë, apo jo?

3 PË. Po ai në brigadë ka qenë. Aty ka qenë vazhdimisht.

4 PY. Po ju nuk e dini se kush ia dha këto kompetenca atij, apo
5 jo, nga i gjeni ai këto kompetenca?

6 PË. Jo, nuk e di dhe s'kam qenë asnjëherë me të në prezent.

7 Nuk kam qenë me këto që ju ka dhënë një urdhën pej zone ose
8 pej dikuj tjetër. Nuk e di pej kujna i ka marrë kompetencat.

9 PY. Kur i thatë Prokurorit që unë nuk e di nga ai ka gjetur
10 ai këto detyra apo nga i merrte urdhrat, i qëndroni ende kësaj
11 sot që ju nuk e dinit këtë gjë?

12 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di.

13 PY. Pra, ju nuk keni njohuri të drejtpërdrejtë nga i merrte
14 ai urdhrat apo kush ia jepte detyrat?

15 PË. Jo, nuk e di.

16 PY. Ju nuk e dini a ka qenë komanda e zonës, shefi i
17 shërbimit të informimit.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Rowan, është
19 përgjigjur tre a katër herë kësaj pyetjeje.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në rregull. Po vazhdoj.

21 PY. Dëshmitar, kur keni folur me ZPS-në ju keni thënë kështu:

22 "Mesa di unë dhe mesa kuptoja unë, ai urdhrat i merrte
23 ... nga zona e Llapit."

24 Dëshmitar, a është e drejtë të themi që kur ia keni thënë
25 ju këtë Prokurorisë thjesht e keni supozuar por nuk e keni

1 ditur me siguri?

2 PË. Jo, nuk e kam dit. E kam thënë pej hamendjes dhe e kam
3 thënë ashtu. Vetëm pej hamendjes e kam fol se s'e kam dit.
4 Edhe sot e dite nuk e kam dit. Atëherë s'e kam dit as tash nuk
5 e di pej kujna i ka marrë udhnat. Po e kam thënë pej
6 hamendjes.

7 PY. Po. Po a pajtoheni me mua që personi më i mirë për ta
8 thënë këtë është vetë z. Xhemajli, se ai e di më mirë se të
9 gjithë të tjerët prej kujt i merrte urdhrat, apo jo?

10 PË. Nuk e kuptova?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan, e
12 keni shteruar këtë linjë pyetjesh. Të lutem, kaloni tek një
13 temë tjetër.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kam dhe një fragment që dua ta
15 trajtoj me dëshmitarin pastaj do të flas me raportimin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë, z. Berisha. Do
18 t'ju lexoj diçka që ka thënë z. Agron Xhemajli sa i takon
19 marrëdhënies që kishte ai me komandant Remin. Ai ka thënë
20 kështu.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për procesverbal, numri 076501-TR-
22 ET Pjesa 3, faqja 7, rreshti 2.

23 PY. Ai tha:

24 "Gjatë gjithë periudhës kohore asnjëherë nuk kemi marrë
25 asnjë urdhër nga komandant Remi. Ne i bënim vetë punët në

1 terren, goftë në armatimet, furnizimet luftimet. Nuk kam marr
2 asnjë urdhër apo kërkesë nga komandant Remi që të më thoshte
3 mua sesi të veproja. Ai ka ardh të na shihte dy a tri herë. Na
4 ka pyetur, 'Çfarë keni bërë deri tani'? I treguam çfarë kishim
5 bërë çfarë kishim bërë. Dhe na tha, 'Mirë, vazhdoni kështu'. I
6 kërkuam ndihmë dhe përkrahje. Ai tha, 'Nuk ju ndihmoj dot'.
7 Dhe kaq."

8 Tani, z. Berisha, ju e kontestoni dëshminë e z. Xhemajlit
9 lidhur me këtë?

10 PË. Jo. Unë s'e kontestoj.

11 PY. Tani do flasim për vijën e raportimit. Kur keni dhënë
12 intervistë për ZPS-në, ZPS-ja ju ka pyetur nga e dini ju që
13 Agron Xhemajli raportonte komandës së zonës. Ti ke thënë
14 kështu:

15 "Ne e dinim edhe nga të tjerët, s'kishte asgjë për të
16 fshehur."

17 Z. Berisha, por a është e vërtetë që ju thjesht e kishit
18 dëgjuar këtë por nuk e dinit me siguri dhe nuk mund të thoni
19 me 100 për qind siguri që kështu ka funksionuar?

20 PË. Jo, nuk mund të them 100 për qind edhe nuk e di. Nuk e
21 di. Nuk e di.

22 PY. Kur keni folur me ZPS-në gjatë intervistës suaj --

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do t'ju vë dhe referencën -- më
24 falni është numër prove, ka numrin P01645.1. Ju i keni thënë
25 ZPS-së kështu:

1 "Nuk na lejohej të flisnim drejtpërdrejt me eprorët sa i
2 takon punës që i lejohej të bënte dhe që nuk i lejohej të
3 bënte."

4 A është e vërtetë, z. Berisha që ju nuk mund t'i pyesnit
5 eprorët apo komandantët sa u takon detyrave që kishin?

6 PË. Po, e vërtetë është se nuk mund të pyes unë. As kemi pas
7 kompetenca për me e pyet edhe me e dit çka vepron komandanti
8 dhe tjera gjëra.

9 PY. Supozoj që ju pajtoheni me mua kur them unë që z.
10 Xhemajli është personi më i mirë për të na thënë ne se cili
11 ishte vija e raportimit, apo jo?

12 PË. Po, po.

13 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj diçka që ka thënë z. Xhemajli në
14 të shkuarën.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe referenca për Trupin Gjykses
16 është 076501-TR-ET Pjesa 1, faqja 17, rreshti 15.

17 PY. Ai ka thënë kështu:

18 "Pasi merrnim këto informacionet për lëvizjet e forcave
19 serbe, shkonim në një pikë takimi ku bashkoheshim të gjithë
20 ne, shokët që përmenda më përpara. Ndanim informacionet që
21 kishim dhe përpiqeshim ta shfrytëzonim këtë informacionin për
22 të mbrojtur pozicionet që kishim ne në zonë.

23 "PY. Po, kujt ia raportoni ju këtë informacion në
24 komandën e zonës?"

25 Ai është përgjigjur:

1 "Jo, jo nuk bëhej rregullisht. Nuk ka qenë procedurë
2 formale. Por kur takohesha, për shembull, me Remin flisnim për
3 këtë gjë. Ai pyeste, 'Si po shkojnë gjërat nga ana juaj'? Dhe
4 diskutonim dhe këtë gjë. Por nuk kishte, nuk ekzistonte një
5 vijë raportimi e rregullt. Nuk na pyeste njeri për këtë gjë."

6 Z. Berisha, e kontestoni këtë që ka thënë z. Xhemajli?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kundërshtoj, dëshmitari deri
8 tani ka thënë që nuk e dinte se kujt i raportonte Xhemajli dhe
9 se nuk ka qenë i pranishëm gjatë takimeve ku mblidhej
10 informacion. Nuk mendoj që është dëshmitari personi i duhur
11 për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Por për nga mënyra si e bëra unë
13 pyetjen, unë thjesht e pyeta a e konteston.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 [Përkthim] Riformuloheni pyetjen, ju lutem.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

17 PY. Z. Berisha, e kontestoni ju dëshminë e z. Xhemajli lidhur
18 me këtë?

19 PË. Jo, s'e kontestoj.

20 PY. Në rregull. Tani, dua të flasim për Latif Gashin.

21 Z. Xhemajli, Latif Gashi ka qenë shefi i shërbimit
22 informativ për zonën e Llapit. E dinit ju këtë gjë?

23 PË. Me pyet z. Xhemajli a mua?

24 PY. Më falni. Më falni, Z. Berisha. Ngatërroj mbiemrat. Z.
25 Berisha.

1 PË. Edhe një herë pyetjen nëse ka mundësi.

2 PY. Patjetër. Thjesht ju pyeta që a e keni ditur ju që ka
3 qenë Latif Gashi shef i shërbimit informativ në zonën e
4 Llapit?

5 PË. Jo, s'e kam dit.

6 PY. Kur thoni që nuk keni pas dijeni, e keni fjalën për
7 periudhën gjatë luftës?

8 PË. Po.

9 PY. Po pas luftës, a jeni vënë në dijeni të faktit që ai ka
10 qenë rol që ka luajtur zotëria në fjalë?

11 PË. Po.

12 PY. Sa i takon ndërveprimeve me z. Gashi gjatë luftës, është
13 e vërtetë që ju e keni takuar atë vetëm një herë gjatë luftës,
14 apo jo?

15 PË. Po, vetëm një herë.

16 PY. Ju nuk është se ju ka dhënë ndonjëherë ndonjë detyrë
17 drejtpërdrejt ai?

18 PË. Jo, asnjëherë.

19 PY. Ju nuk keni punuar asnjëherë me të në rolin tuaj si
20 polici ushtarake, si polic ushtarak, apo jo?

21 PË. Jo, asnjëherë.

22 PY. Dhe mund të duket e kuptimtë, por si rezultat i takon që
23 ju nuk jeni në gjendje që të na ndihmoni lidhur me atë se
24 çfarë ka bërë Latif Gashi gjatë luftës, çfarë pozicioni, çfarë
25 posti ka pas ai apo çfarë veprimtarish ka kryer ai gjatë

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 73

1 luftës. Është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Është e saktë se nuk e di. Nuk e di çfarë veprimesh e ç
3 postesh e çka ka bë. S'kam njohuri kurrgjë.

4 PY. Dhe për pasojë rezulton se ju, z. Berisha, nuk keni
5 informacion, nuk keni njohuri se kujt i ka raportuar ai apo
6 nga kujt i ka dhënë urdhra, në qoftë se i ka raportuar apo i
7 ka dhënë urdhra ndokujt, kështu?

8 PË. Jo, jo, nuk kam njohuri.

9 PY. Sipas Agron Xhemajlit ai nuk i ka raportuar Latif Gashit
10 dhe sipas tij ai është takuar me të vetëm sy herë gjatë
11 luftës. Ju nuk keni arsye për ta kontestuar këtë gjë, apo jo?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kam të njëjtin kundërshtim si
13 më herët.

14 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Jo, nuk e di unë sa
15 herë --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
17 Mund t'i përgjigjeni.

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dëshiroj që t'ju bëj një pyetje që
19 jua ka bërë në fakt edhe Prokuroria gjatë një intervistimit.
20 Pyetja që ju ka bërë Prokuroria --

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe referenca për këtë është
22 072914 -- në fakt kemi një numër prove që është P01645.1, në
23 faqen 20, rreshti 21.

24 PY. Në intervistën e ZPS-së, ZPS-ja ju ka bërë këtë pyetje:

25 "Latif Gashi, si shef i shërbimeve të zbulimit për zonën,

1 çfarë detyre i ka caktuar ai Agron Xhemajlit?"

2 Ju i jeni përgjigjur kështu:

3 "Po, ky ka qenë zinxhiri i komandës."

4 Tani, të ndalojmë këtu. Duke marr parasysh atë që sapo
5 thatë, domethënë, sa i takon gjendjes tuaj dhe kufizimeve që
6 dini ju ose kufizimeve dhe të njohurive tuaja sa i tako roleve
7 dhe detyrave për raportimin e Latif Gashit, prapë e keni këtë
8 qëndrim apo do thoni që nuk e dini?

9 PË. Jo, jo, nuk e di. Nuk e di.

10 PY. Sikurse e thatë dhe më herët, ju e keni mësuar pas lufte
11 që Latif Gashi ka qenë shefi i shërbimeve të zbulimit për
12 Llapin dhe e dinit që z. Xhemajli, e keni mësuar, pra, që z.
13 Xhemajli ka qenë përgjegjës për shërbimin e zbulimit për
14 brigadën. A është e saktë të thuhet që kur jeni përgjigjur
15 kësaj pyetjeje për Prokurorin, përderisa kishte kuptim për sa
16 i takon zinxhirit të komandës, ju keni hamendësuar se duhet të
17 ketë qenë kështu marrëdhënia ndërmjet tyre, por ndërkohë nuk
18 është se keni pas njohuri apo dijeni faktike sa i takon rolit
19 dhe detyrave të tyre?

20 PË. Absolut se jo nuk e kam dit. Nuk e kam dit.

21 PY. Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Tully.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë dëshmitar.

25 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 75

1 Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Alagendra, mund të vazhdoni.

4 Pyetje të palës tjetër nga znj. S. Alagendra:

5 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Përshëndetje, Dëshmitar.

6 Mirëdita. Unë quhem Shyamala Alagendra dhe jam

7 përfaqësuese e Jakup Krasniqi sot. Kam pak pyetje për ju.

8 Kështu që ju lutem më dëgjoni me vëmendje.

9 Pyetja e parë që kam për ju ka të bëjë me zonën e
10 Karadakut.

11 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] I referohem paragrafit 18
12 të Shërbimit Përgatitor 2.

13 PY. Në Shënimin Përgatitor 2 thuhet që ju i keni treguar

14 Prokurorisë se zona e Karadakut nuk ka bashkërenduar

15 veprimtaritë e veta me Brigadën 153 dhe që ka funksionuar ose

16 ka punuar në mënyrë të pavarur. A mund të na e konfirmoni se

17 kjo është e saktë, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
20 paraqesë në ekran provën P1655.

21 PY. A mund të shikoni këtë fotografi që keni në ekran sepse

22 jua tregoi dhe më herët Prokurori sot këtë fotografi. Do ju

23 kërkoja që të shikonit pak këtë shenjën në krahë të

24 uniformave, a mund të konfirmoni për neve që në to shkruhet

25 TMK, domethënë, janë distinktivë --

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 76

1 PË. TMK.

2 PY. -- dallues të TMK-së?

3 PË. Po.

4 PY. Është e saktë, apo jo, që TMK-ja është krijuar pasi u
5 shpërbë UÇK-ja, domethënë, UÇK-ja në atë kohë nuk ekzistonte
6 më? Është e saktë kjo?

7 PË. E saktë.

8 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë
9 të mbyllur shkurtimisht.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
11 në seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
9 të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni, znj. Alagendra.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. I keni thënë Prokurorisë në intervistën tuaj.

14 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe i referohem këtu provës
15 P01645.3, faqe 18 deri në 19.

16 PY. I keni thënë Prokurorisë deri në 2005 ju keni shkuar në
17 Francë ku keni qëndruar për një periudhë dhe ku keni kërkuar
18 azil. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

19 PË. Po. Në 2005 a 2006. Në 2006.

20 PY. A mund t'ju pyes, zotëri, se ku e keni mbështetur
21 kërkesën tuaj, e keni mbështetur në çështjet për të cilat keni
22 dhënë dëshmi përpara këtij Trupi Gjykses? Vetëm me "po" ose
23 "jo", nuk duam shtjellime të mëtejshme se jemi në seancë
24 publike.

25 PË. Jo. Jo, nuk e kam mbështet në të, se atëherë as nuk kam

Dëshmitari: Halim Berisha (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 78

1 pas as ftesë as nuk jam marr në pyetje nga kjo Gjykatë për me
2 e mbështetë në atë.

3 PY. Po baza për kërkesën tuaj, a përfshinte të njëjtin rast
4 për të cilin mund të keni dhënë dëshmi në procedurën përpara
5 kësaj Gjykate?

6 PË. Jo. Nuk mund të përfshihet në të. Kjo ka qenë më shumë
7 për shkaqe ekonomike.

8 PY. A i keni dhënë ZPS-së vendimin që e rrëzonte kërkesën
9 tuaj për azil?

10 PË. S'ma ka kërku kërrkush.

11 PY. Faleminderit.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera për
13 ju.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Pyetje plotësuese nga Prokuroria ka?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi, të nderuar
17 Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
19 nuk kemi pyetje të tjera për ju. Ky është fundi i dëshmisë.

20 Jeni i lirë që të largoheni, nuk keni detyrime të tjera ndaj
21 Gjykatës. Mund të largoheni nga vendi ku jeni nën shoqërinë e
22 Sekretares.

23 Po ashtu faleminderit shumë dhe Avokatit të Caktuar
24 kryesisht, faleminderit që e ndihmuat dëshmitarit,
25 faleminderit, pra, Avokatit Kujdestar.

1 Edhe mund të largoheni të dy tani.

2 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit edhe
3 ju.

4 Z. OSAJ: [Përmes videolidhjes] Ditën e mirë.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
6 videolidhjes]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, znj.
8 Rowan.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të bëj
10 një korrigjim për procesverbalin për një referencë. Unë e
11 thashë gabim faqen 58, rreshti 9, në transkriptin e ditës së
12 sotme. Ndërkohë që referenca e saktë duhet të jetë Pjesa 1.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit ju.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
16 rreth 20 minuta pushim në mënyrë të tillë që të bëjmë
17 organizimet e nevojshme për dëshmitarin e radhës. Do mblidhemi
18 përsëri në orën 12.30. Ju lutem sigurohuni që të jeni në
19 sallën e gjyqit në atë kohë.

20 Jemi në seancë publike, kështu që dhe një herë po them që
21 do bëjmë pushim deri në orën 12.30.

22 --- Seanca ndërpritet në orën 12.12

23 --- Seanca rifillon në orën 12.33

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
25 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 04366,

1 cili do të shfaqet përmes videolidhjes.

2 Ju lutem, sillni dëshmitarin në ambientin ku ndodheni.

3 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes
4 videolidhjes]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Për
6 procesverbal, në vendin nga po bëhet videolidhje është i
7 pranishëm Dëshmitari me numër 03666 edhe unë, Sekretarja e
8 seancës.

9 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
10 Dëshmitar.

11 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sekretarja e Gjykatës
13 që është me ju aty bashkë, do t'ju japi betimin solemn të
14 cilin duhet ta bëni në bazë të Rregullores së Gjykatës.

15 Qëndroni në këmbë fillimisht. Çohuni në këmbë, Dëshmitar.
16 Merre tekstin që po të jep Sekretarja dhe lexoje me zë të
17 lartë.

18 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për
19 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore,
20 deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të
21 vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë
22 asgjë për të cilën kam dijeni.

23 DËSHMITARI: W04366

24 [Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Mund të ulësh.

2 Dëshmitar, pikësëpari, a na dëgjon mirë?

3 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.

5 Sot do fillojmë me dëshminë tënde që mendohet se do të
6 zgjasë më pak se një ditë. Në fillim do t'i bëjë pyetjet
7 Prokuroria. Më pas ekipet e Mbrojtjes. Dhe në fund mund t'ju
8 bëjnë pyetje Gjykatësit.

9 Prokuroria ka kërkuar gjysmë ore për t'ju bërë pyetje.
10 Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar një orë e tridhjetë minuta, të
11 katërta ekipet së bashku. Ju lutem të gjithë palëve të jenë të
12 kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës që ju kemi dhënë për
13 pyetjet. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese nëse
14 plotësohen kriteret përkatëse.

15 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
16 nuk e kuptoni një pyetje lirisht thoni që nuk e kuptoni
17 pyetjen në mënyrë që ne pyetjen ta sqarojmë. Gjithashtu na
18 thoni ju ku e bazoni faktet, rrethanat për të cilat do t'ju
19 bëjmë pyetje.

20 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të flisni për
21 korrigjimet që i keni bërë deklaratës suaj, ju lutem thoni me
22 zë për procesverbal që deklarata me shkrim bashkë me
23 korrigjimet përkatëse pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

24 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
25 se të përgjigjeni. Dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

1 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi përpara këtij Trupi
2 Gjykues, nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e
3 dëshmisë suaj. Në qoftë se dikush ju bën pyetje jashtë
4 Gjykatës për dëshminë, menjëherë na informoni.

5 Mos flisni më nëse jua kërkoj unë. Dhe, ju lutem, mos
6 flisni më kur të ngre unë dorën, ç'ka do të thotë që unë duhet
7 të jap një udhëzim.

8 Në çdo moment që keni nevojë për një pushim na thoni që
9 të bëjmë organizimin përkatës.

10 Tani do të fillojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.
11 Dëshmitar, dëgjojini me vëmendje.

12 Z. Prokuror, fjala është për ju.

13 Pyetje nga z. De Minicis:

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Faleminderit që erdhët. Emri juaj --

16 PË. Mirëdita.

17 PY. Emri juaj a është [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mendova se
22 ishim në seancë private. Duhet ta fshijmë këtë informacion që
23 sapo thashë.

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. DE MINICIS: [Nuk ka përkthim].

Dëshmitari: W04366 (Seancë private)
Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 83

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës
2 të vendosë në ekran materialin, 059345-TR-AT [Sipas
3 përkthimit] RED2 dhe versionin përkues.

4 Pra, ju kërkoj ndjesë. Ua dhashë gabimin gabim [Sipas
5 përkthimit]. Është pjesa RED2 059351-TR-AT RED.

6 PY. Dëshmitar, a e shihni dokumentin që doli në ekran?

7 PË. Po.

8 PY. Kjo është pjesa e parë e një interviste që i keni dhënë
9 Prokurorisë në 2019-n. Të kujtohet që ke bërë një intervistë?

10 PË. Po, më kujtohet.

11 PY. A të kujtohet që këtë intervistën ta treguam gjatë
12 seancës përgatitore; ishte një kolegu im atje javën e kaluar.
13 Të kujtohet?

14 PË. Po.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për
16 dokumentin e radhës do të doja të kalonim në seancë private.
17 Do ju jap dhe arsyen pse.

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
19 seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, e patë edhe një herë -- a t'u dha mundësia të

21 rishikoje dhe një herë dokumentin që sapo diskutuam gjatë

22 seancës përgatitore? I pe edhe një herë ato që kishe thënë?

23 PË. Po.

24 PY. Pasi i pe dokumentet kërkove të bëje disa ndryshme, në

25 qoftë se të kujtohet. Disa lapsuses, gabime ortografike, po

1 edhe disa informacione që gjendeshin në dokumente, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Pasi i mbarove deklaratat ne të gjitha ndryshimet që
4 kërkove ti i hodhëm në një shënim dhe më pas atë shënimin ta
5 lexuam prapë ty, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Pasi ta lexuam shënimin, ti the që tani janë reflektuar
8 saktë të gjitha ndryshimet që kërkova unë, kështu?

9 PË. Q'ashtu është.

10 PY. Tani, duke marrë parasysh dhe ndryshimet që i bëmë ne dhe
11 i hodhëm tek ai shënimi, bashkë me ndryshimet, deklaratat tani
12 a pasqyron saktësisht atë që do të thojë dhe sot ti po të të
13 bënin të njëjtat pyetje?

14 PË. Po.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, gjykojmë që
16 kemi përmbushur kriteret e rregullës 154 dhe kërkujmë pranimin
17 e Shënimit Përgatitor numër 1, me ERN 122749 deri në 122752
18 dhe të rreg -- materialeve të rregullës 154 që ju keni
19 konstatuar se janë të pranueshme në vendimin e 13 shtatorit
20 2024, përkatësisht me numër F02571 paragrafët 113 deri në 11 -
21 - 122.

22 Të gjitha materialet janë të renditura në poshtëshënimin
23 226 të vendimit.

24 Nëse është e nevojshme unë mund t'ju jap numrin e plotë
25 të referencës.

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

2 kundërshtime?

3 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me

5 numër 059351-TR-AT, Pjesa 1 -- sa pjesë ka?

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ka tre pjesë -- tri pjesë.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Të

8 tri pjesët, 1, 2, 3 RED2, pranohen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto pjesët marrin

10 numrin e provës P01660.1 për Pjesën 1; P0166 -- 60.2 dhe

11 Pjesën 2; dhe P01660.3 për Pjesën 3. Këtu përfshihet dhe

12 anglishtja dhe shqipja.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] ERN-ja e deklaratës së dytë nuk

14 duhet lexuar për publikun.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 [Përkthim] Atëherë, shënimi përgatitor ka numër 122749

17 deri në 122752 dhe pranohet.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor merr

19 numrin P01661.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

21 atëherë. Kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen

7 tuaj dua të lexoj një përmbledhje të shkurtër për këtë

8 dëshmitar. Ja kemi dërguar dhe Mbrojtjes me 12 shtator 2024.

9 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në 1999, Dëshmitari 04366 u

11 arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së dhe e çuan te fabrika e

12 metalit në Kukës. Atje Dëshmitari 04366 u keqtrajtua, u mor në

13 pyetje dhe u mbajt në kushte çnjerëzore. Ai dëshmoi me sytë e

14 tij keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë dhe mund të japë disa

15 dëshmi sa i takon vdekjes së një personi.

16 Me kaq mbyll përmbledhjen.

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 PY. Unë kam disa pyetje shtesë për ju.

20 Ju keni dhënë dëshmi dhe kjo gjendet në [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR] - ju thatë që -- në fakt duhet të jemi në seancë

22 private për këto pyetje.

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në

24 seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Dëshmitar, tani do bëjmë një pushim. E kemi çdo ditë këtë

6 pushimin për një orë e gjysmë. Do ktheheni në orën 2.30

7 sërish. Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj. Tani mund të

8 dilni nga dhoma ku ndodheni në shoqërinë e Sekretares së

9 seancë së Gjykatës. Drekë të mirë.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes

11 videolidhjes]

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

14 --- Seanca rifillon në orën 14.31

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Asistente, mund ta sillni te vendi ku jeni dëshmitarin.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Përpara sesa vijojmë me

18 kundërpjetjet, dua të them që të gjitha pyetjet e mia duhet të

19 bëhen në seancë private.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në

23 seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 jemi në seancë publike.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Faleminderit. I përfunduar çështjet për sot. Nuk e di në qoftë
14 se ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar nga ekipet. Në qoftë se
15 nuk është ky rasti, do të takohemi përsëri bashkë të hënën në
16 mëngjes në orën 9.00. Seanca mbyllet këtu.

17 --- Seanca mbyllet në orën 14.45

18

19

20

21

22

23

24

25